



Pranuar / Dorezuar Prijmjen / Predato Received / Delivered	21. 04 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Org / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMSHICK	2314 / 2022		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.211/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi- Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi -Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.211/2022 të datës 07.03.2022 të parashtruar nga ankuesja Komuna e Lipjanit, kundër organit të punësimit/Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.211/2022, e datës 07.03.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. MBETET në fuqi Vendimi me numër KD.nr.001/2022 i datës 09.02.2022, i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 07.03.2022, me numër protokolli 1201/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, kundër vendimit të datës 09.02.2022, të Komisionit Disiplinor lidhur me masën disiplinore „ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë rritjen në shkallën e pagës për periudhën dy vjet“.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshill, më datë 16.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Shërbimi Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 04.04.2022, ka pranua nga Shërbimi

Korrektues të Kosovës përgjigjen në kërkesë me numër protokolli:1840/2022, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 211/2022 të datës 07.03.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 09.02.2022, me numër protokolli 001/22, të Komisionit Disiplinor; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit i datës 15.03.2022; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 01.08.2019; Vendimi me numër protokolli 1187, i datës 20.01.2021, për Themelimin e Komisionit Disiplinor; Shkresën për iniciimin e procedurës disiplinor të datës 12.01.2022; Raporti i Hetimit i Shërbimit Korrektues të Kosovës i datës 30.12.2021; Shkresën zyrtare të ankuesit e datës 30.12.2021 me numër Nr.12/21; Raportin propozues nga Komisioni multidiciplinar për menaxhimin e rasteve me rrezik për vetëvrasje i datës 14.05.2021 me numër reference MSh/DSh/QKFL/55/2021; Deklaratën e datës 31.12.2021 të Zv/Drejtoreshës

Regjistrimet ditore të gjendjes dhe sjelljeve të burgosurit:

Deklaratën e datës 31.12.2021 të udhëheqëses së pavijonit

Raportin e Ngjarjes i datës 30.12.2021 nënshkruar nga Raportin mbi gjendjen shëndetësore të paraburgosurve të datës 02.11.2021 me numër Nr.508; Raportin mbi gjendjen shëndetësore të paraburgosurve të datës 10.09.2021 me numër Nr.551; Raportin mbi gjendjen shëndetësore të paraburgosurve të datës 20.09.2021 me numër Nr.576; Raportin e ngjarjes të datës 30.12.2021 i nënshkruar nga Raportin e ngjarjes të datës 30.12.2021 i nënshkruar nga Deklarata e Deklarata e Raportin e vetëvrasjes së të burgosurës i datës 30.12.2021 përgatitur nga Njoftimin për vdekje në burg i datës 30.12.2021; E-mailin e datës 30.12.2021 dërguar nga për

Raportin lidhur me rastin e vetëvrasjes të dënuarës i datës 06.01.2022 me numër prot:01-03 PËRGATITUR NGA Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.02.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 07.03.2022; Vendimin e datës 20.10.2021 për themelimin e Komisionit Ër; Ndryshimin dhe Plotësimin e kontratës së ankuesit të datës 11.02.2020; Kontratën e punës së ankuesit të datës 09.07.2013; fletë kthesën e datës 10.02.2022; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit e datës 03.01.2020; Regjistrimet ditore të gjendjes dhe sjelljeve të burgosurit të datës 30.12.2021; E-mailin e datës 03.09.2021 dërguar nga

Njoftimin e datës 06.09.2021 dërguar nga menaxheri i rastit dërguar për Regjistrimet ditore të gjendjes dhe sjelljeve të burgosurit e datës 29.12.2021; Regjistrimet ditore të gjendjes dhe sjelljeve të burgosurit e datës 28.12.2021; Raporti i Mbledhjes Shëndetësore i rastit i datës 30.12.2021 përgatitur nga Udhëheqëse e

NJSHB/QKFL; Deklaratën e datës 30.12.2021 nga Kryeinfermiera Deklaratën e datës 30.12.2021 nga Raporti Mjekësor i datës 30.12.2021; Raportin e

Ngjarjes i datës 30.12.2021 nga Plani Eventual-Vdekja në burg-Procedura e veprimit të oficerit në dhomën e kontrollit i datës 30.12.2021; Deklaratën 38 të

Deklaratën 39 e Shkresën e datës 30.12.2021 me numër rendor:304 me shkresën e bashkangjitur të datës 31.12.2021 prej tre (3) faqesh; Procesverbalin e intervistës me stafin i datës 05.01.2022 me katër (4) shkresat e bashkangjitura të datës 31.12.2021; Shkresën e procesverbalit të datës 05.01.2022 i orës 10:30; Shkresën e procesverbalit të datës 05.01.2022 i orës 09:50; Shkresën e procesverbalit të datës 05.01.2022 i orës 14:55; Shkresën e procesverbalit të datës 05.01.2022 i orës 14:00; Shkresën e procesverbalit të datës 05.01.2022 i orës 11:00; Shkresën e procesverbalit të datës 06.01.2022 i orës 10:35; Shkresën e procesverbalit të datës 06.01.2022 i orës 11:25; Shkresën e procesverbalit të datës 06.01.2022 i orës 12:15; Kartoni i

evidencës së vizitorëve sipas listës së planifikuar Form 3.3.2/1; Kërkesa për kontrollë ose hospitalizim e datës 15.09.2020 për Kërkesa për kontrollë ose hospitalizim e datës 15.02.2021 për Fletë lëshimi i datës 25.03.2021 me numër amzës:34/29; Raporti i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i datës 28.04.2021 në përbërje prej njëzetedy (22) faqesh; Aktvendimin me numër P.nr.328/21e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm i datës 27.04.2021; Aktgjykimin me numër P.nr.328/21 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm i datës 25.05.2021; Aktgjykimin me numër PA1.nr.798/2021 i Gjykatës së Apelit të Kosovës i datës 19.08.2021; Vendimi për formimin e komisionit të brendshëm hetimor i datës 31.12.2021; Aktvendimin e Panelit për lirim me kusht me numër PLK.D.nr.563/21; Raportet përmbledhëse për lirim me kusht i datës 17.09.2021; Kualifikimi për shqyrtim për lirim me kusht për të dënuarën i datës 20.09.2021; Raportin përmbledhës nga Ekipa profesioniste e institucionit korrektues për lirim me kusht i datës 27.09.2021; Raportin shëndetësor për të burgosurën i datës 23.09.2021; Deklaratën e datës 24.09.2021; Raporti Social për falje i datës 27.09.2021; Deklarim-premtim lidhur me mbikëqyrjen pas lirimit me kusht; Raporti përmbledhës për gjykatë për lirim me kusht të parakohshëm i datës 23.12.2021; Kërkesa për lirim të parakohshëm i datës 23.12.2021; E-mailin e datës 24.12.2021 dërguar nga për Raporti i vlerësimit për regjime i datës 04.10.2021; vendimin e datës 07.05.2021 i Drejtorit të QKFL; Raportin Inicues disiplinor; Njoftimi i të burgosurit për akuzën dhe kohën e seancës dëgjimore i datës 06.05.2021; Shënimin Zyrtar i datës 06.02.2021; Vendimin e datës 06.10.2021; Raporti inicues i datës 05.10.2021; Procesverbalet e seancave të komisionit për datat respektive 24 dhe 25.01.2022 për ankuesin dhe të tjerët; Raport inicues ër i datës 02.09.2021; Raport inicues ër i datës 06.04.2021; Shkresën zyrtare të datës 06.04.2021; Deklaratën e Raport për dëmtime trupore eventuale i datës 06.04.2021; Plani eventual-vdekje ne burg i datës 30.12.2021; Raportin e vizitave i datës 30.12.2021; Raportin mi gjendjen shëndetësore të paraburgosurve i datës 03.09.2021; regjistrin mbi informatat e të burgosurës me numër: QP-LP:000029/21; Procesverbali i intervistës me të datës 22.01.2022; Deklaratën e datës 30.12.2021; Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për intervistë të datës 21.01.2022 për Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për intervistë të datës 21.01.2022 për Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për Regjistrimet ditore të gjendjes dhe sjelljeve të burgosurit për datën 30.12.2021 nga ora 03:30 deri në ora deri në ora 12: (i pa identifikueshëm numri); Deklaratën e Udhëheqëses së pavijonit e datës 31.12.2021; Raporti i Ngjarjes i datës 30.12.2021 nga zyrtarja Raporti i vetëvrasjes së të burgosurve i datës 30.12.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e *pabazuar*, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila ka pretenduar së Komisionit Disiplinor, me vendimin e datës 09.02.2022, ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore, „ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë rritjen në shkallën e pagës për periudhën dy vjetë”. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi që i ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët,

Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankueses _____ nuk janë të bazuar, sepse ankuesja me veprimet e sajë lidhur me detyrat e punës ka bërë shkëlje të detyrave të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar së lidhur me shqiptimin e masës disiplinore, nga Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, me vendim të datës 09.02.2022, me të cilin ankueses _____ i ka shqipëruar masën disiplinore *“ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë rritjen në shkallën e pagës për periudhën dy vjet”*, ka vepruar në pajtim me 47, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik, ku thuhet se; 1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë:1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet, si dhe në pajtim me nenin 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1,dhe 1.2 të Rregullores (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku thuhet se; 1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore, sepse nga shkresa të lëndës, të parashtruara nga palët, del së me datë 30.12.2021, ankuesja _____ në pozitën *“Udhëheqëse e Pavijonit”*, në Qendrën Korrektues në Lipjan, nuk i ka ndërmarr veprimet e duhura, lidhur me ndodhjen e vet vrasjes së të burgosurës me inicialte M.K, e cila ka qenë duke e vuajtur burgim pranë kësaj qendre, sepse në bazë të raportit të hetimit të datës 11.01.2022, me numër 0023, të Shërbimit Korrektues, konstatohet se „Udhëheqësja e Pavijonit”, edhe pse ka qenë e informuar që e dënuara ishte e mbyllur për shkak të disa informacioneve, e njëjta në ditën kritike, nuk e ka vizatuar asnjëherë të dënuarën, si dhe nga raporti i datës 06.01.2022, me numër protokolli 01-03, lidhur me rastin e vetëvrasjes së të dënuarës M.K, i bërë nga Inspektori i Ministrisë së Drejtësisë, është konstatuar se ka pasur komunikime në mesë menagjmentit të cilat komunikimi nuk kanë qenë të duhura sa i përket kordinimit dhe si pasoj shihet se ka pase neglizhencë në kryrjen e detyrave të punës nga ankuesja dhe të tjerët të përfshir ne rast.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses, _____ lidhur me shqiptimin e masës disiplinore, kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se masa disiplinore është shqiptuar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, nenin 46, paragrafi 1, 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik, ku thuhet se 1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës;

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka marr për bazë edhe raportin hetimor të inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë të datës 06.01.2022, Kolegji për shqyrtimin e dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar së ankuesja është gjetur përgjegjës për faktin: “se ankuesja përmes “SMS” ka vendosur ta mbyll të ndjerën M.K në një dhomë të pavijonit pa respektuar procedurat e mirëfillta si dhe është konstatuar se nuk kanë bërë vizitat e nevojshme tek e e burgosura tani më e ndjera, edhe pse kanë qenë në dijeni përmes informatave inteligjente se e njëjta është interesuar se sa denohesh nëse e vret një të burgosurë, prandaj Kolegji ka marr si rrethanë faktike që ankuesja ka dështuar në përmbushjen e detyrave sipas standardeve të parapara në këto raste, andaj Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues më të drejtë ka shqiptuar masën në fjalë ndaj ankuese.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se nëpunësja Civile Remzije Luma, me veprimet e sajë, ka vepruar në kundërshtim me nenin me nenin 25, paragrafi 1,2,3 të Ligjit Nr. 06/1 -114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se; 1.Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës.3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar së në bazë të shkresave të leëndës, përkatësisht në bazë të vendimit të datës 09.02.2022, të nxjerrë nga Komisioni Disiplinor, është konstatuar së ankuesja është përgjegjës për veprimet e sajë, lidhur me ndodhjen e rastit me datë 30.12.2021, në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan (Qendra Korrektuese për Femra).

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, në rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 09.02.2022, të Komisionit Disiplinor, me të cilin vendim ankueses i është shqiptuar masa disiplinore „ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë rritjen në shkallën e pagës për periudhën dy vjetë“, ka vepruar në pajtim me dispozitat Ligji nr. 06/1 -114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me rastin e ankueses

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të leëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.211/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtoria të Përgjithshme të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Sekretaria të Përgjithshme të Ministrisë së Drejtësisë
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivat të KPMSHCK-së